



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik , Komuna e Prishtinës shpallë :

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

POZITA: Vozitës – tre (3) ekzekutues

Dy vozitës me patentë shofer te kategorisë “B”

Një vozitës me patentë shofer te kategorisë “D”

KOEFICIENTI : 5

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE :

MBIKËQYRJA: Udhëheqësi i Sektorit dhe Drejtori

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Drejton automjetin, kujdeset për mirëmbajtjen e tij, si për pastrimin - larjen, lyerjen, evitimin e prishjeve etj;
- Përgjigjet për mirëmbajtjen e automjetit dhe pajisjet e tij;
- Udhëheq bllokun e fletudhëtimeve, duke regjistruar relacionet e udhëtimeve, numrin e kilometrave të kaluara;
- Paraqet defektet eventuale të automjetit tek bashkëpunëtori i Sektorit dhe jep sqarime lidhur me ato defekte;
- Kryen edhe punë të tjera, sipas udhëzimeve të bashkëpunëtorit të Sektorit dhe të shefit të sektorit.

Për punën e tij, i përgjigjet udhëheqësit të sektorit dhe drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- 3 vjet përvojë punë;
- Të ketë patentë shoferi, kategoria "B" (2 ekzekutues)
- Të ketë patentë shoferi, kategoria "D" (1 ekzekutues)

Data e shpalljes së Konkursit : 01.02.2016 deri me dt. 15.02.2016

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitën e cekur më lart.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

- Dëshmi të kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dokument të identifikimit;
- Dëshmi që nuk jeni i ndjekur penalisht;
- Dëshmi të patentë shoferit të kategorisë "B" apo "D"

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Sektorin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në nr. të tel. 038- 230-900, lok.10-70.